“Melekët nuk hyjnë në atë shtëpi që ka qen ose piktura (frymorësh).”

Ebu Talhai (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Melekët nuk hyjnë në atë shtëpi që ka qen ose piktura (frymorësh).”
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se melekët e mëshirës nuk hyjnë në atë shtëpi ku ka qen ose ndonjë pikturë të qenieve të gjalla. Kjo, se piktura e diçkaje që ka frymë është një mëkat i rëndë, se përmban imitim të krijimit të Allahut dhe është mjet drejt shirkut. Madje, disa prej tyre janë piktura që adhurohen në vend të Allahut. Sa i përket arsyes së abstenimit të tyre nga një shtëpi ku ka qen, është për faktin se ai ha shumë papastërti dhe për shkak se disa prej tyre quhen shejtanë, ndërkohë melekët janë kundër shejtanëve. Dhe se qeni mban erë të keqe, ndërsa melekët e urrejnë erën e keqe... Rrjedhimisht, ai që i mban këto piktura, ndëshkohet në atë formë që melekët e mëshirës privohen të hyjnë në shtëpinë e tij, të falen aty, të kërkojnë falje për të, të luten për bekim për të dhe për shtëpinë e tij e për ta larguar dëmin e shejtanit prej tij.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/8950